

# **U miratua Udhëzuesi i ASHMA-së për monitorimin e zbatimit të standardeve për raportimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në media**

**Shkup, 9 nëntor 2021** – Në seancën e sotme të 32-të, Këshilli i Agjencisë e miratoi Udhëzuesin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele për monitorimin e zbatimit të standardeve për raportimin e rasteve të dhunës në bazë gjinore në media. Dokumenti është përgatitur nga ekspertja e angazhuar nga Këshilli i Evropës në kuadër të projektit “Liria e shprehjes dhe liria e medimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut”– JUFREKS 2, zbatuar nga Këshilli i Evropës dhe Unioni Evropian .

Udhëzuesi ndër të tjera ka për qëllim të ju sigurojë medimeve dhe të gjitha palëve të interesuara, informacionet e nevojshme për ta shqyrtuar çështjen për raportimin e dhunës në bazë gjinore në përgjithësi, për shkak të së cilës bën kryqëzim të kushteve në këtë plan në vend, shpjegon kuptimin e rregullimit dhe vetërregullimit, ofron një pasqyrë të dokumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare dhe të regjistrit legjislativ të brendëshëm, tregon praktikën e mira që duhen ndjekur në raportimin dhe siguron një sërë pyetjesh në lidhje me të cilat, gjatë mbikqyrjes duhet të analizohen shtojca/programi për të cilin ekziston dyshimi se nuk i respekton standardet për rastet e dhunës në bazë gjinore.

Ky dokument do të promovohet në eventin online, „Dhuna në bazë gjinore në media: situata, drejtimet, monitorimi“, që do të mbahet më **11 nëntor 2021, me fillim në ora 11.00**. Në këtë ngjarje do të prezantohet dhe Hulmtimi mbi mbulimin mediatik

të temave që lidhin me komunitetin LGBT në bazë të dhunës gjinore, përgatitur nga Koalicioni Margini/me mbështetjen e Fondacionit Hejnrik Bell dhe Manuali për ndjeshmërinë gjinore në media,përgatitur nga HOPS/UN Women.

Të gjitha palët e interesuara, mund të ndjekin eventin online në Facebook linkun  
– <https://www.facebook.com/events/432081611850728/>.